

I FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

PETIDINE

Tretësirë për injeksion – 100 mg / 2 ml
(*Petidinë klorhidrat*)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Petidine dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Petidine
- Si ta merrni Petidine
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Petidine
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË PETIDINE DHE PËRSE PËRDORET

Petidina është një analgjezik opioid sintetik, që vepron kryesisht si agonist opioid i receptorëve µ. Petidina ka veprime e përdorime të ngjashme me morfinën, por ajo është më e tretshme në yndyrna se morfina dhe ka veprim analgjezik më pak të fortë dhe me kohëzgjatje më të shkurtër. Efekti i saj analgjezik zgjat 2 – 4 orë.

Petidine indikohet në:

- qetësimin e dhimbjeve në tumore malinje;
- neurite të rënda;
- çrregullime të veprimtarisë së lindjes (tkurrje të forta të shoqëruara me dhimbje gjatë zgjerimit mbi 3 cm);
- edemë pulmonare akute;
- qetësimin e spazmave të muskulaturës së lëmuar të aparatit tretës, të rrugëve biliare e urinare;
- paramjekimin para anestezisë së përgjithshme;
- qetësimin e dhimbjeve pas ndërhyrjeve kirurgjikale.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Petidine për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI PETIDINE

Mos merrni Petidine në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj petidinës klorhidrat, ndaj barnave të ngjashme, ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të tretësirës;
- pacienti është në gjendje komatoze;
- keni depresim të frymëmarrjes ose sëmundje me bllokim të rrugëve të frymëmarrjes;
- keni rritje të presionit intrakranial;
- keni trauma të kokës;
- keni risk për ileus paralitik;
- vuani nga feokromocitoma;
- mjekoheni me frenues të monoaminoksidazës (IMAO) ose nëse nuk kanë kaluar ende dy javë nga ndërprerja e mjekimit me këto barna;
- vuani nga çrregullimet konvulsive;
- vuani nga dëmtimet renale ose hepatike të rënda.

Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, këshillohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Petidine

- Petidina duhet përdorur me kujdes të veçantë dhe me doza të reduktuara tek të porsalindurit dhe tek fëmijët, në të sëmurët e moshuar e të dobësuar, tek ata me *Myasthenia gravis*, çrregullime të traktit biljar, hipotiroidizëm, hipotension, insuficiencë adrenokortikale, shok, hipertrofi të prostatës, takikardi supraventrikulare, kor pulmonar të rëndë, stenoze uretrale, obstruksjon ose sëmundje inflamatore të zorrës.

- Kujdes duhet treguar edhe për të sëmurët që ndodhen në fazën e alkoolizmit kronik. Mos përdorni alkool gjatë mjekimit me petidinë meqenëse përgjigjia individuale nuk mund të parashikohet.
- Petidina e deprimon qendrën e frymëmarrjes dhe prandaj duhet përdorur me kujdes të veçantë në të sëmurët me insuficiencë respiratore, astmë (të shmanget në atak akut) dhe tek ata me funksion respirator të dëmtuar.
- Përdorimi i përsëritur mund të shkaktojë tolerancë ndaj saj, me një prirje për t'i rritur dozat me qëllim që të arrihet efekti i duhur. Ajo mund të shkaktojë varësi fizike dhe psikologjike të tipit të morfinës, me shfaqjen e simptomave të abstinencës pas ndërprerjes së menjëhershme të mjekimit.
- Mund të zhvillohet tolerancë e kryqëzuar midis analgjezikeve narkotikë.
- Akumulimi i metabolitëve të petidinës mund të çojë në neurotoksicitet.

Nuk është e përshtatshme për mjekimin e dhimbjeve kronike.

Marrja e barnave të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin nëse merrni, keni marrë së fundmi apo do të merrni barna të tjera gjatë trajtimit, edhe nëse bëhet fjalë për barna pa recetë sepse barnat e mëposhtëm kryesisht, mund të ndikojnë ose të ndikohen nga petidina:

- deprimuesit e sistemit nervor qendror (trankuilizuesit, alkooli), sepse kur kombinohen me petidinën mund të japin depresim aditiv të këtij sistemi;
- barnat e përdorur për të trajtuar depresionin si antidepressivët triciklikë dhe frenuesit e rikapjes së serotoninës sepse rrisin rrezikun për toksicitet dhe depresim të sistemit nervor qendror;
- antihistaminikët sedativë, sepse mund të theksohen efektet sedative;
- barnat e përdorur për të trajtuar ankthin sepse rrisin rrezikun për toksicitet dhe depresim të sistemit nervor qendror;
- barnat e përdorur në trajtimin e skizofrenisë dhe sëmundjeve të tjera serioze të sistemit nervor qendror, fenotiazinat sepse japin një qetësim të theksuar, hipotension dhe zgjatje të depresimit respirator;
- frenuesit e monoaminoksidazës nuk duhet të merren njëkohësisht me petidinën dhe as nëse nuk kanë kaluar ende dy javë nga ndërprerja e mjekimit me këto barna sepse mund të ndodhë eksitim apo depresim i sistemit nervor qendror;
- rasagilinë, selegilinë, moklobemid, nuk duhet të merren njëkohësisht me petidinën dhe as nëse nuk kanë kaluar ende dy javë nga ndërprerja e mjekimit me këto barna;
- analgjezikët dhe preparatet e tjera opioide;
- hidantoinat (fenitoina, fosfenitoina) sepse rrisin metabolizimin hepatic të petidinës, ulin efektin e saj, rrisin rrezikun për toksicitet nga norpetidina;
- ritonaviri sepseulet përqëndrimi i petidinës, rritet përqëndrimi i norpetidinës dhe toksiciteti nga ky metabolit;
- cimetidina (për trajtimin e ulçerës dhe djegieve gastrike) sepse rritet mundësia e depresimit të frymëmarrjes dhe sistemit nervor qendror;
- nalmefeni nuk duhet të përdoret njëkohësisht me petidinën;
- oksibat natriumi, sepse petidina thekson efektet e këtij bari, ndaj duhet shmangur përdorimi i njëkohshëm.

Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit nëse njëkohësisht me Petidine merrni edhe barnat e përmendura më sipër.

Marrja e Petidine me ushqim dhe pije

Nuk duhet të përdorni alkool gjatë mjekimit me petidinë sepse përgjigjia individuale nuk mund të parashikohet. Efekti sedativ dhe hipotensiv theksohet.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni një shtatzëni dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë kësaj periudhe. Petidina e kalon shpejt placentën dhe kur përdoret gjatë lindjes mund të shkaktojë depresion respirator dhe sindromën e abstinencës tek i porsalinduri. Përdorimi i petidinës në shtatzëni mund të bëhet vetëm në rastet absolutisht të domosdoshme dhe nën një mbikqyrje të kujdesshme.

Ushqimi me gji

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësht gjiri dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë kësaj periudhe. Petidina ekskretohet në qumështin e gjirit, çka bën të domosdoshëm kujdesin që duhet treguar nëse ajo përdoret në këtë periudhë.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Petidina mund t'i dëmtojë aftësitë e të sëmurit për të drejtuar automjetin ose për të punuar me makineri.

3. SI TA MERRNI PETIDINE

Gjithmonë merreni Petidine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Petidine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

- Për trajtimin e dhimbjes*

Të rritur, me injektim nën lëkurë ose në muskul:

25 – 100 mg që mund të përsëritet pas 4 orësh;

Me injektim të ngadalshëm në venë:

25 – 50 mg që mund të përsëritet pas 4 orësh.

- Fëmijët, me injektim në muskul:*

0.5 – 2 mg / kg / peshë.

- Analgjezia obstetrike, me injektim nën lëkurë ose në muskul:*

50 – 100 mg që në rast nevoje mund të përsëritet 1 – 3 orë më vonë; doza maksimale është 400 mg në 24 orë.

- Paramjekim përpara operacionit, me injektim në muskul:*

25 - 100 mg, 1 orë para operacionit.

Për të moshuarit dhe personat me fizik të dobësuar rekomandohet që të bëhet një reduktim doze.

Në qoftë se keni marrë më shumë Petidine

Ky bar do ju administrohet në spital, ndaj nuk ka shumë gjasa që të ndodhë mbidozim, gjithsesi njoftoni menjëherë mjekun nëse mendoni se keni marrë një dozë më të lartë se ajo që duhet.

Dozat e larta mund të shkaktojnë: konvulsione, vështirësi në frymëmarrje, tremor, hipotermi, etj.

Në qoftë se harroni të merrni Petidine Ky bar do ju administrohet në spital, ndaj nuk ka shumë gjasa që të ndodhë harresë, gjithsesi nuk duhet marrë dozë e dyfishtë (ose më e lartë) për të kompensuar dozën e harruar.

Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Petidine

Trajtimi nuk duhet të ndërpritet menjëherë ose pa u konsultuar më parë me mjekun. Doza duhet të reduktohet gradualisht për të minimizuar simptomat e abstinencës. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo, megjithëse jo çdokush i manifeston. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:

- në sistemin respirator: depresim respirator, i cili është ndër efektet më shqetësuese, depresim i refleksit të kollës, laringospazma;
- në SNQ ose efekte psikiatrike: varësi fizike dhe psikologjike të tipit të morfinës, marrje mendsh, çorientim, përgjumje, haluçinacione, eufori, disfori, çrregullime humori, çrregullime të gjumit, dhimbje koke;
- në traktin gastro-intestinal: të përziera, të vjella, konstipacion, dhimbje barku, spazma biliare, tharje goje;
- në sistemin kardiovaskular: hipotension, hipotension ortostatik, takikardi, bradikardi, skuqe në fytyrë, palpitacione;
- dermatologjike: rash, kruarje, urtikarie, probleme në vendin e injektimit (irritim lokal, dhimbje, skuqe);
- në traktin genitourinar: mbajtje e urinës, spazma të ureterëve;
- të tjera: djersitje, edema, reaksione të rënda mbindjeshmërie (ngushtim i papritur në krahavor dhe mbajtje fryme, enjtje e qepallave, fytyrës, buzëve, urtikarie dhe ɽlluska në lëkurë, rash, kruarje dhe temperaturë, kolaps), miozë dhe çrregullime të pamjes, çrregullime seksuale.

Përdorimi i përsëritur mund të shkaktojë tolerancë ndaj saj, me një prirje për t'i rritur dozat me qëllim që të arrihet efekti i duhur.

Në rastet e mbidozimit shkakton dridhje, konvulsione, ngurtësi muskulare. Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të përmendura më sipër ju shqetëson. Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendu-ra në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI PETIDINE

Mbajeni larg fëmijëve! Mos e përdorni Petidine pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C! Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM



Çfarë përmban Petidine - Tretësirë për injeksion
Lënda vepruese është petidinë klorhidrat. Çdo ampulë 2 ml përmban 100 mg petidinë klorhidrat. **Përbërësit e tjerë janë:** acid klorhidrik ose hidroksid natriumi për rregullim pH, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Kuti me 10 ampula dhe kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

 Sipas recetës së mjekut.

 Përmbajtja.  Kujdes.

 Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim (MAT) dhe Prodhuesi:

 **PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u formulua për herë të fundit në Korrik 2016.